



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

APLIKO SI MONITORUES

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, vendimit nr. 81, datë 15.7.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesëshme për kryetar të Bashkisë Himarë, datë 4.8.2024”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të caktojë monitorues për bashkinë si më poshtë vijon:

BASHKIA	VENDET VAKANTE
Bashkia Himarë	1

KRITERET E APLIKANTËVE:

- 1) Të jetë i padënuar,
- 2) Të ketë përfunduar studimet universitare ose të jetë duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë.
- 3) Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike të paktën 2 (dy) vitet e fundit

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë aplikantët për pozicionin e punës, monitorues:

- a) Kërkesën për t’u emëruar si monitorues që përmban: qarkun për të cilin aplikon, përvojën e aplikantit dhe adresën e banimit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e tel./cel.,
- b) Dëshmi penaliteti,
- c) Kopje të noterizuar të diplomës ose vërtetim që është duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë të noterizuar,
- ç) Kopje të dokumentit të identifikimit,
- d) Vetëdeklarim se nuk është anëtar i ndonjë partie politike për 2 (dy) vitet e fundit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhët udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
- dh) Raport të aftësisë për punë,



- e) Vetëdeklarim i banimit,
- ë) Fotokopje e certifikatës si monitorues në zgjedhje të mëparshme (nëse disponojnë).

Prioritet për t'u përzgjedhur do kenë kandidatët të cilët kanë qenë pjesë të zgjedhjeve të mëparshme.

AFATI PËR DORËZIM E DOKUMENTEVE:

19.07.2024